

**FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS**  
**KOSOVA KARATE FEDERATION**



**RREGULLORE PËR MJEKËSI**

Prishtinë, 2021

## **1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi:**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave për Mjekësi në Federatën e Karatesë së Kosovës, që kanë të bëjnë, por nuk kufizohen me:

1. Ruajtja e shendetit të sportistëve dhe stafit të Federatës së Karatesë së Kosovës;
2. Ruajtja e shendetit të Publikut dhe personelit që nuk janë pjesëmarrës në garat dhe organizimet e FKK-së;
3. Sanimi i lendimeve të lehta nga pjesëmarrësit në garat e organizuara nga Federata e Karatesë së Kosovës.

### **Neni 2**

#### **Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet nga Komisioni për mjekësi për Federatën e Karatesë së Kosovës. Ky komision do të përcjell gjendjen shëndetësore të garuesve të FKK-së dhe mbajë regjistër me të dhëna shëndetësore për anëtarët e përfaqësueses së FKK-së.

## **2. KOMISIONI PËR MJEKËSI DHE PËRBËRJA E TIJË**

### **Neni 3**

Komisioni për mjekësi përbëhet nga 3 anëtarë. Bordi i Federatës së Karatesë të Kosovës do të përzgjedhë kryesuesin e komisionit me konkurs. Kryesuesi duhet të jetë së paku mjekë i përgjithshëm me përvojë në mjekësinë sportive.

### **Neni 4**

Anëtarë të Komisionit do të caktohen nga kryesuesi i komisionit dhe do të miratohen nga Bordi Ekzekutiv. Ata/o mund të jenë persona që kanë mbaruar Fakultetin e Mjekësisë (mjekët specialist, specialistët e mjekësisë sportive, mjekët e praktikës së përgjithshme, tarumatolog), si dhe personat që kanë kryer shkollën e lartë të terapisë fizikale (fizioterapeutët).

### **Neni 5**

Komisioni për mjekësi takohet sipas nevojës, por së paku tri here Brenda viti të cilën e thërret kryetari i komisionit me vetiniciativ, apo me kërkesë të Bordit Ekzekutiv.

## **3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË**

### **Neni 6**

1. Komisioni Mjekësor do të jetë përgjegjëse për mbikëqyrjen mjekësore në të gjitha garat e organizuara nga FKK.
2. Komisioni Mjekësor duhet të bashkëpunojë ngushtë me Komisionin e Garave, Komisionin e Gjqëtarëve, Komisionin për Siguri dhe Shëndet, Komisionin për Trajner të FKK-së, gjatë garave dhe organizimeve tjera të miratuara nga Bordi Ekzekutiv i Federatës së Karatesë së Kosovës.
3. Komisioni Mjekësor do të bëjë raport me shkrim për secilën garë dhe organizimet tjera të miratuara nga Bordi i Federatës së Karatesë së Kosovës dhe do t'ia përcjellë me shkrim Bordit Ekzekutiv të FKK-së.
4. Ky raport do të përmbajë statistika dhe komente mbi dëmtimet (lëndimet) dhe pikëpamjet e tjera mjekësore dhe rekomandimet për përmirësime.
5. Ky raport do të kompletohet jo më vonë se 10 ditë pas Kampionatit dhe garave, kampeve përgaditore dhe garave jashtë vendit dhe Kryetari i Komisionit Mjekësor do të jetë direkt përgjegjës për të.

#### **4. PAISJET MINIMALE MJEKSORE DHE PERSONELI**

##### **Neni 7**

1. Për organizimin e një Gare të FKK-së duhet të sigurohet numër i mjaftueshëm i mjekeve.
2. Së paku duhet të jetë një mjekë mbikqyrës dhe personeli i tij përcjellës (infirmieri), sipas numrit të tatamive.
3. Një tavolinë mjekësore për dy tatami, e pozicionuar në mënyrë që të lejojë personelin mjekësor të ndërhyjë shpejtë në tatami, dhe të ketë kontakt të lehtë vizuel të gjyqtarëve me mjekët, në rast se kërkohet ndihmë mjekësore gjatë një ndeshje sportive.
4. Të paktën një mjekë me përvojë në garën e karatesë për dy tatami, nese gara e karatesë zhvillohet në më shumë se dy tatami nevojiten se paku një mjekë dhe dy infermier për të ofruar mbikëqyrje mjekësore të ngjarjes duke ndjekur standardet e FKK-së.

##### **Neni 8**

1. Komisionit Mjekësor është i obliguar që të bëjë regjistrimin e lëndimeve në çdo ngjarje zyrtare të FKK-së.
2. Mjeku kryesor i garës duhet të jetë në gjendje që të ofrojë shërbim emergjent për lëndimet e mundshme në garë.

##### **Neni 9**

1. Komisioni Mjekësor duhet të jetë në gjendje të ofrojë pajisjet si më poshtë:
  - a) Pajisjet themelore të fashimit (shirita me madhësi të ndryshme, fashë pambuku dhe elastik, shirita steril, shirit ngjitës, etj);
  - b) Pajisjet e linjës së parë për të trajtuar qarjet dhe prerjet në vend (ujë, anti-septik, solucione, solucion kripë sterile, hemostatikë, depresorë të gjuhës, llamba xhepi, gërsërë, material për tampon hundë, fasha ndihmëse, etj);

- c) Numër të mjaftueshëm të dorezave sterile të disponueshme për secilin ekzaminim;
- d) Një tjetër sportist duhet të ekzaminohet ose trajtohet
- e) Ilaçe analgjetike dhe të ndihmës së parë, duke shmangur ilaçet e përfshira në listën e WADA-s të substancave të ndaluara;
- f) Mjete të nevojshme për kujdesin për sytë;
- g) Spërkatje të ftohtë dhe / ose akull të copëtuar në qese plastike;
- h) Faculeta letre ose të ngjashme për pastrim;
- i) Dhëmbëzat;
- j) Si dhe mjete tjera që Komisioni mendon se janë të nevojshme;

2. Komisioni për nevoja të veta, për regjistrim të lëndimeve duhet të ketë formularët për regjistrat mjekësorë dhe të plotësojë të dhënat e lëndimeve dhe të njëjtat ti raportojë Bordit Ekzekutiv të FKK-së.

### Neni 10

1. Funkzioni i Komisionit Mjekësor është të ndihmojë gjyqëtarët në garë për të përcaktojë nivelin e lëndimit dhe garuesi i lënduar është në gjendje të vazhdojë ndeshjen.
2. Komisioni Mjekësor mund të ndihmojë procesin e kontrollit të dopingut në Kampionatet zyrtare, duke punuar së bashku me Gjyqtaret për Grumbullimin e Mostrave dhe zyrtarët anti-doping të emëruar në kampionate.
3. Komisioni Mjekësor mbanë takime të rregullta me komision sa herë që është e nevojshme, nese Bordi Ekzekutive e shef të nevojshme per sqarime e therret kryetarin e komisionit për mjekësi për raportim para Bordit Ekzekutivë.
4. Mbi bazën e këtyre diskutimeve Komisioni Mjekësor i bën propozimet dhe rekomandimet Bordit Ekzekutiv të Federatës së Karatesë së Kosovës.

### Neni 11

1. Një përfaqësues i Komisionit Mjekësor do të merr pjesë në seminarët për trajner/gjyqëtarë për të shkëmbyer informacione në lidhje me përmirësimet të ndryshme mjekësore si dhe të njihet me rregullat e garave.
2. Komisioni Mjekësor duhet të jetë i informuar edhe për përdorimin e 4 shkallëve të lëndimeve:

**Shkalla 1:** Lëndim shumë i lehtë pa zvogëlim të aftësisë së garuesit për të fituar ndeshjen.

**Shkalla 2:** Lëndim i lehtë mesatarisht me një zvogëlim të vogël të aftësisë së garuesit për të fituar ndeshjen.

**Shkalla 3:** Lëndimi mesatarisht i rëndë (megjithëse në gjendje të vazhdojë ka një ulje të konsiderueshme të aftësisë së atletit për të fituar ndeshjen.

**Shkalla 4:** Lëndimi serioz që garuesi duhet të tërhiqet nga gara sportive.

## **5. ÇERTIFIKATA MJEKËSORE**

### **Neni 12**

1. Në gara mund të merr pjesë vetëm garuesi i cili ka çertifikatën e rregullit mjekësore, të vërtetuar nga institucioni përkatës mjekësor.
2. Çertifikata mjekësore nuk duhet të jetë më e vjetër se 12 muaj. Në rast të kundërt garuesi nuk do të lejohe të merr pjesë në garë.
3. Komesari dhe Komisioni i garave janë përgjegjës për kongrollimin e çertifikatave mjekësore të garuesve në periudhën e regjistrimit të garuesve.

## **6. KUJDESI MJEKËSOR PËR GARUËS GJATË DHE PAS NJË GARE**

### **Neni 13**

1. Gjatë garës mjeku kujdestar është personi i autorizuar që mund të marrë vendim për ndalimin e garimit të mëtutjeshëm të garuesit si në rastet në vijim:
  - a) Kur lëndimet e garuesve mund të kenë pasoja të rënda nëse vazhdon garimin.
  - b) Kur dyshon se garuesi ka përdorur Substanca të Ndaluara.
  - c) Në raste tjera, kur vlerëson se është rrezikuar gjendja shëndetësore e garuesit.

### **Neni 14**

1. Kur gjatë një periudhe, një garues ka pësuar dëmtime, zyrtari mjekësor ka të drejtë të kërkojë që lufta të ndalet për arsye shëndetësore.
2. Gjygtari duhet të informohet nga mjeku i garës se lufta do të pezullohet.
3. Nëse një garues rrëzohet si rezultat i një goditjeje ose goditjeve dhe mbetet pa ndjenja, vetëm Gjygtari dhe Zyrtari Mjekësor duhet të qëndrojnë në tatami nëse zyrtari mjekësor nuk ka nevojë për ndihmë shtesë.
4. Një garues i cili ka pësuar (ose dyshohet se ka pësuar) një tronditje truri do të ekzaminohet nga zyrtari mjekësor menjëherë më pas.
5. Në të gjitha rastet e tronditjes, garuesi kurrë nuk duhet të mbetet pa mbikëqyrje derisa të shërohet plotësisht dhe duhet të shoqërohet në spital nëse është e nevojshme.

6. Pas tronditjes garuesi nuk guxon të lejohet të largohet nga mbikëqyrja e mjekut kujdestar të garës.

## 7. RASTET E TRONDITJEVE

### Neni 15

#### *Një tronditje*

Një garues i cili ka pësuar një tronditje të vërtetuar gjatë një gare ose kur Gjygtari e ka ndaluar garën për shkak se garuesi ka marrë goditje të forta ose goditje në kokë duke e bërë të paaftë për të vazhduar, nuk do të lejohet të marrë pjesë në garë për një periudhë prej të paktën dy javësh pas diagnostifikimit.

#### *Dy tronditje*

Një garues i cili ka pësuar një tronditje të vërtetuar dy herë në një periudhë prej tre muajsh nuk do të lejohet të marrë pjesë në garë gjatë një periudhe prej tre muajsh nga tronditja e dytë.

#### *Tre tronditje*

Një garues i cili ka pësuar një tronditje të vërtetuar tri herë në një periudhë prej 12 muajsh nuk do të lejohet të marrë pjesë në garë në periudhë prej një viti nga tronditja e tretë.

### Neni 16

Para se të rifilloni garen garuesi që ka pësuar tronditjet e përshkurara në Nenin 15 do të duhet që të paraqes Komisionit Mjekësor dhe Komisionit të Garave çertifikatën mjekësore nga një neurolog se ai/ajo mund të garojë përsëri.

## 8. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni 17

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga data e aprovimit nga Bordi Ekzekutiv dhe nënshkrimin nga kryetari i FKK-së.

Prishtinë, 19 qershor 2021

Ismet Krasniqi

